



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.39/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), për shkak të vendosjes së posterave në objektet publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1,400.00 (njëmijë e katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 02.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 02.06.2017 në rrugën Bajram Kelmendi në Prishtinë monitoruesit e tyre kanë vërejtur se posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik KDTP është i vendosur në objekt publike përkatësisht në transformator të energjis elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 03.06.2017, subjekti politik KDTP thekson se posterat e kandidateve për deputet nga KDTP janë larguar nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato, dhe në të njëjtën kohë i bashkangjitur si dëshmi fotografit.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga subjekti politik KDTP është vendosur në objekt publik gjegjësisht në transformatorin e nergjis elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë*

fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jasht objekteve publike ose godinave”

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik KDTP është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterit i kandidatit për deputet nga subjekti politik KDTP, është i vendosur në objekt publik, të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet subjekti politik në përgjigjen në ankesë të datës 03.06.2017

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik KDTP, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti se posterit i kandidatit për deputet nga ky subjekt politik është vendosur në objekt publik gjegjësisht në transformatorin e nergjisë elektrike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarr veprime për të bërë përmasimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.39/2017 më datën 06.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.